



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

**Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo unutrašnjih poslova - Ministry of
Internal Affairs**

**RREGULLORE (MPB) NR. 01/2024 PËR THEMELIMIN, PËRBËRJEN,
MANDATIN, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KOMISIONIT TË
ANKESAVE PËR ORGANIZATAT JOQEVERITARE¹**

¹ Rregullore (MPB) 01/2024 për Themelimin, Përbërjen, Mandatin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit të Ankesave për Organizatat Joqeveritare, është miratuar me Vendimin Nr.0489/2023 të datës 03.09.2024 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në mbështetje të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-244 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/1-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, nenit 11, paragrafit 1, nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në pajtim me nenin 9, paragrafin 2 të Rregullores Nr. 17/2024 për Punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

**RREGULLORE (MPB) NR. 01/2024 PËR THEMELIMIN, PËRBËRJEN, MANDATIN,
DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KOMISIONIT TË ANKESAVE PËR
ORGANIZATAT JOQEVERITARE**

**Neni 1
Qëllimi i Rregullores**

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është themelimi dhe përcaktimi i detyrave, përgjegjësiwe, përbërja dhe mandati i anëtarëve të Komisionit të Ankesave ndaj Vendimeve të Departamentit për Organizatat Joqeveritare, si dhe përcaktimi i rregullave të punës së Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Kjo Rregullore zbatohet nga Komisioni i Ankesave, me rastin e shqyrtimit të ankesave të personave fizikë dhe juridikë kundër Vendimeve të Departamentit për Organizatat Joqeveritare.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet, termet dhe shkurtesat e përdorura në këtë Rregullore, kanë këto kuptime:
 - 1.1. **DOJQ** – nënkupton Departamentin për Organizatat Joqeveritare;
 - 1.2. **Komisioni** – nënkupton Komisionin e Ankesave;
 - 1.3. **Ministria** - nënkupton Ministrin përgjegjëse për administratë publike;
 - 1.4. **Ministri** – nënkupton Ministrin e Ministrisë përgjegjëse për administratë publike;
 - 1.5. **Përfaqësues i Autorizuar** – nënkupton individin që është rezident në Kosovë, që ka moshë madhore dhe zotësi të veprimit, që është i autorizuar për ta përfaqësuar OJQ-në.
2. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e tjera të përdorura në këtë Rregullore, kanë kuptimin e njëjtësi në përkufizimin e përcaktuar në ligjin përkatës për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare.

3. Përdorimi i fjalëve në një të njëjtin gjini, nënkupton edhe gjininë tjetër.

Neni 4

Përbërja, Emërimi dhe Mandati i anëtarëve të Komisionit të Ankesave

1. Komisioni i Ankesave për DOJQ-në formohet me Vendim të Ministrit.
2. Komisioni i Ankesave përbëhet prej tre (3) anëtarëve, së paku një (1) prej të cilëve jurist dhe një (1) pjesëtar i komuniteteve jo shumicë, si në vijim:
 - 2.1. Dy (2) përfaqësues nga MPB;
 - 2.2. Një (1) përfaqësues nga OJQ-të.
3. Njëri nga përfaqësuesit e MPB-së, caktohet Kryesues i Komisionit.
4. Organi i shkallës së parë, përjashtohet nga përbërja e komisionit.
5. Anëtarët e Komisionit të Ankesave emërohen me mandat tre (3) vjeçar, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat.
6. Në përbërjen e anëtarëve të Komisionit të Ankesave, respektohet barazia gjinore.

Neni 5

Përzgjedhja e Anëtarit Përfaqësues nga OJQ

1. Përzgjedhja e përfaqësuesit nga OJQ bëhet përmes thirrjes publike.
2. Thirrja publike bëhet përmes faqes së Ministrisë.
3. Përfaqësuesi nga OJQ-të duhet të plotësojë kriteret si në vijim:
 - 3.1. të ketë diplomë universitare të paktën 240 kredi, kurse për diplomat e marra jashtë vendit, nevojitet nostrifikimi;
 - 3.2. të ketë (8) vite angazhim në OJQ, prej të cilave pesë (5) vite në pozita të nivelit menaxherial;
 - 3.3. të mos ketë qenë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
 - 3.4. të mos ketë qenë i dënuar për kryerjen e një veprë penale me burgim më shumë se një (1) vit.

4. Ministria publikon shpalljen publike në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për pranimin e aplikimeve për përfaqësues të OJQ-ve në Komision.
5. Ministria më së largu dhjetë (10) ditë pas datës së mbylljes së shpalljes publike si në paragrafin 4 të këtij neni, përgatit listën kandidatëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara si në paragrafin 3 të këtij neni dhe të njëjtën e dërgon te Ministri.
6. Ministri bën përzgjedhjen nga lista sipas paragrafit 5 të këtij neni.

Neni 6 **Përgjegjësitë e Komisionit**

1. Komisioni vendos lidhur me ankesat e parashtruara kundër Vendimeve për:
 - 1.1. refuzimin e regjistrimit të OJQ-së;
 - 1.2. pezullim apo revokim të statusit për përfitim publik;
 - 1.3. çregjistrimin e OJQ-së;
 - 1.4. çdo Vendimi tjetër të DOJQ për të cilin parashikohet e drejta e ankesës sipas Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare.

Neni 7 **Detyrat e Kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit**

1. Punën e komisionit e udhëheq dhe e bashkërendon Kryesuesi i Komisionit.
2. Anëtarët e komisionit janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit, kur atyre u kërkohet nga kryesuesi dhe të kryejnë punën me përgjegjësi dhe objektivitet.

Neni 8 **Procedura e ankesës**

1. Në rast se pala e pakënaqur parashtron ankesë ndaj Vendimit të DOJQ-së, siç parashikohet në nenin 6 të kësaj Rregulloreje, procedura ankimore zhvillohet nga Komisioni.
2. Komisioni, si organ i shkallës së dytë, zhvillon procedurën në bazë të ankesës dhe vendos lidhur me të.
3. Ankesa dorëzohet dhe nënshkruhet nga pala ankuuese, përfaqësuesi i autorizuar apo përfaqësuesi ligjor në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Në ankesë duhet të ceket numri dhe data e Vendimit të cilit i referohet ankesa.
4. Ankesa dorëzohet në zyrën e arkivit të Ministrisë, e cila, pastaj e dorëzon ankesën në Komision.

5. Pala mund të parashtrojë ankesë edhe nëpërmjet postës e cila i bëhet e njohur në këshillën juridike të Vendimit.

6. Pas pranimit të ankesës, komisioni së pari vërteton nëse ankesa është ngritur ndaj një vendimi të DOJQ-së ndaj të cilit lejohet ankesa me ligj, se a është bërë brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe nëse është bërë nga personi i autorizuar apo përfaqësuesi ligjor. Ankesa e palejuar, e bërë jashtë afatit ligjor dhe nga personi i paautorizuar, hidhet poshtë me vendim nga komisioni.

7. Pala ankuese mund të paraqesë ndonjë fakt ose argument ligjor që nuk është shqyrtuar më parë nga organi i shkallës së parë ose të pohojë se organi i shkallës së parë ka bërë gabim faktik, ligjor ose procedural gjatë marrjes së vendimit. Ankesa duhet të specifikojë kundërshtimin e një apo më shumë aspekteve të Vendimit të organit të shkallës së parë, si në vijim:

7.1. shkelje e dispozitave të së drejtës materiale;

7.2. shkelje e dispozitave të së drejtës procedurale;

7.3. konstatim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike;

7.4. prova të reja të rëndësishme në mbështetje të kërkesës.

Neni 9 Seancat

1. Komisioni, kur e vlerëson të arsyeshme, ose me kërkesë të njëjës nga palët, mund t'i thërrasë palët që të marrin pjesë në Seanca.

2. Palët njoftohen me shkrim për kohën, datën dhe vendin ku do të mbahet Seanca.

Neni 10 Palët në seancë dhe përfaqësimi juridik

1. Palët në seancë janë pala ankuese dhe DOJQ.

2. Pala ankuese mund të përfaqësohet në seancë nga përfaqësuesi i saj, i cili duhet të paraqesë autorizimin me shkrim përmes të cilit vërtetohet se është përfaqësues i palës.

Neni 11 Organizimi i seancës

1. Seancën e udhëheq kryesuesi i Komisionit.

2. Secili anëtar i Komisionit mund të parashtrojë pyetje apo të kërkojë komente nga palët, lidhur me çfarëdo çështje ligjore ose faktike që ka të bëjë me ankesën.

3. Komisioni mund të kërkojë prova shtesë lidhur me çfarëdo çështje që parashtrohet nga cilado palë gjatë procedurës.
4. Drejtori i DOJQ cakton një zyrtar të Departamentit për të shërbyer si procesmbajtës gjatë seancave, për të mbajtur dosjet e procesverbaleve dhe vendimeve të marra nga Komisioni, si dhe për çdo detyrë tjetër që mund t'i ngarkohet nga Kryesuesi i Komisionit në kuadër të mbarëvajtjes së punës së Komisionit.
5. Procedura zhvillohet në përputhje me ligjin përkatës për procedurën administrative.

Neni 12

Vendimet e Komisionit

1. Vendimi i Komisionit merret me shumicën e votave.
2. Vendimi i komisionit është vendim me shkrim dhe përmban arsyet faktike dhe juridike, si dhe informacionet për kundërshtimin e vendimit sipas mjeteve juridike, duke përfshirë edhe organin në të cilin pala ka të drejtë ta kundërshtojë Vendimin.
3. Vendimi i komisionit nënshkruhet nga kryesuesi i Komisionit.
4. Komisioni me Vendimin e tij mund të:
 - 4.1. refuzojë ankesën dhe lë në fuqi vendimin e DOJQ;
 - 4.2. miratojë ankesën, anulojë vendimin dhe të njëjtin e kthen në rishqyrtim;
 - 4.3. anulojë apo të ndryshojë, plotësisht apo pjesërisht, vendimin e ankimuar.
5. Sekretaria ia dorëzon vendimin palës apo përfaqësuesit të tij të autorizuar.
6. Vendimi fillon të prodhojë pasojat juridike në raport me palën të cilës i drejtohet apo e cila cenohet nga ai, me njoftimin e përmbajtjes të tij.
7. Vendimi, nëpërmjet Sekretarisë i dërgohet edhe organit të shkallës së parë.
8. Vendimi i Komisionit është përfundimtar në procedurën administrative dhe ndaj tij mund të iniciohet konflikt administrativ.
9. Inicimi i konfliktit administrativ sipas paragrafit 8 të këtij neni, nuk e pezullon ekzekutimin e Vendimit.

Neni 13

Procesverbali

1. Për çdo seancë të Komisionit mbahet procesverbal me shkrim.

2. Procesverbali paraqitet për miratim në fund të mbledhjes përkatëse ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet së bashku nga kryesuesi dhe personi që ka mbajtur procesverbalin. Procesverbali duhet të nënshkruhet edhe nga pala ankuese apo përfaqësuesi i tij nëse kanë marrë pjesë në seancë.
3. Përveç procesverbalit nga paragrafi 1 i këtij neni mbahet edhe procesverbali i veçantë i votimit, i cili do të nënshkruhet nga anëtarët e pranishëm.
4. Në procesverbalin e veçantë të votimit nuk ka qasje pala dhe as publiku.
5. Komisioni mund të regjistrojë seancat e komisionit nëpërmjet pajisjeve incizuese. Përdorimi i incizimeve bëhet në përputhje me ligjin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 14

Dorëheqja nga pozita e Kryesuesit apo anëtarit të Komisionit

Kryesuesi ose anëtari i Komisionit i cili planifikon të japë dorëheqje, i ofron Ministrit njoftim paraprak me shkrim, së paku një (1) muaj përpara dhe gjatë kësaj periudhe kohore do të vazhdojë t'i kryej të gjitha detyrat deri në emërimin e një anëtari të ri.

Neni 15

Shkarkimi

1. Ministri mund të shkarkojë kryesuesin dhe anëtarët e Komisionit para përfundimit të mandatit, nëse:

- 1.1. është dënua për vepër penale nga gjykata kompetente;
- 1.2. nuk i arsyeton me shkrim mungesat në seancat e komisionit, tri (3) herë;
- 1.3. jep dorëheqje apo transferohet në një institucion tjetër nga ato të përcaktuara në Nenin 4 të kësaj Rregulloreje;
- 1.4. i është ndërprerë marrëdhënia e punës;
- 1.5. është suspenduar nga marrëdhënia e punës.

Neni 16

Konflikti i interesit

1. Konflikti i interesit është situata në të cilën një anëtar i Komisionit ka një interes personal të tillë, që ndikon ose mund të ndikojë në paanshmërinë ose objektivitetin e kryerjes së detyrës zyrtare si anëtar i Komisionit.
2. Kur anëtari i Komisionit vihet në dijeni se një situatë e tillë ekziston, është i detyruar që:

- 2.1. të verifikojë nëse ai ka një konflikt të tillë;
 - 2.2. të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të shmangur një konflikt të tillë;
 - 2.3. të informojë menjëherë Kryesuesin e Komisionit, përkatësisht Ministrin për konfliktin e mundshëm të interesit;
 - 2.4. të respektojë çdo vendim, për të mos marrë pjesë në seancat e komisionit .
3. Në rast se vërtetohet se njëri nga anëtarët apo kryetari ka konflikt interesi, me Vendim të posaçëm bëhet zëvendësimi i tij i përkohshëm me një anëtarë tjetër.

Neni 17 **Kompensimi**

1. Komisioni mund të kompensohet për punën e tij, për aq kohë sa plotësohen kriteret e parapara në legjislacionin relevant për pagat në sektorin publik.
2. Anëtari përfaqësues nga OJQ-të që nuk është shërbyes civil kompensohet për çdo procedurë të ankesës, pas përfundimit të saj në lartësinë prej njëqind euro (100.00€).

Neni 18 **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Xhelal SVEÇLA

Ministër
Ministria e Punëve të Brendshme

03/09/2024